

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit mbi veadministrimin lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02), Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 15^{të} mbajtur më datë 03.10.2003 solli:

S T A T U T T Ë K O M U N Ë S D I B Ë R

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Komuna Dibër (në tekstin e mëtutjeshëm Komuna) është njësi e vetadministrimit lokal, në të cilën qytetarët e realizojnë të drejtën e vetqeverisjes lokale.

E drejta në vetadministrim lokal realizohet nëpërmjet përfaqësuesve në organet e Komunës dhe me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në vendimarrje.

Neni 2

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë që kanë vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës janë banorë të Komunës së Dibrës.

Territori i Komunës Dibër është përcaktuar me ligj dhe përfshin territoret e vendbanimeve: qytetin e Dibrës dhe fshatrat Banisht, Bomovë, Hame, Kosovrast i Poshtëm, Kosovrast i Epërm, Konjarë, Krifcë, Manastirec, Oxhovcë, Rajçicë, Spas, Sollokiç, Shushicë, Taranik, Tatar Elevcë, Vllasiq, Otishan dhe Zepishtë.

Neni 3

Komuna Dibër është person juridik.

Neni 4

Selia e Komunës Dibër është në qytetin Dibër Rr. "8 Shtatori" nr.72.

Neni 5

Komuna ka të drejtë të pronës.

Neni 6

Komuna e Dibrës ka stemë në formën e mburojës ku janë të përfshira elementet që simbolizojnë lashtësinë dhe arkitekturën e vjetër të qytetit, amamin, xhaminë dhe kishën si simbol i bashkëjetesës, urën mbi lumin Radikë, kalanë si simbol i

qëndresës, ujrat termomineral, liqenin artificial, pendën me hidrocentralin dhe relefin malor.

Neni 7

Komuna e Dibrës ka flamur që është 2 ngjyrash, kuq e zi në formë katërkëndëshi me dimensione 0.75/150 cm dhe në mes në rreth me ngjyrë të verdhë e vendosur stema e Komunës.

Neni 8

Komuna e Dibrës ka vulë në formë rrethi me diametër prej 35 (tridhjetë e pesë)mm në të cilën në formë të rrumbullakët në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe është shkruar teksti:

**РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË
ОПШТИНА ДЕБАР
KOMUNA DIBËR**

Vula që përdor Këshilli i Komunës ka tekstin “KËSHILLI I KOMUNËS” në gjuhën maqedonishte dhe gjuhën shqipe ndërsa në mes është stema e Komunës.

Vula që përdor Kryetari i Komunës ka tekstin “KRYETARI” në gjuhën maqedonishte dhe gjuhën shqipe ndërsa në mes është stema e Komunës.

Neni 9

Komuna ka vulë protokoli në formë të katërkëndëshit këndrejt në gjuhën maqedonishte dhe gjuhën shqipe me këtë tekst

**РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË
ОПШТИНА ДЕБАР - KOMUNA DIBËR**

Бр. Nr _____
_____199_____
ДЕБАР - D i b ë r

Neni 10

Festa e Komunës është “8-të Shtatori” dita e çlirimit të Dibrës nga fashizmi.

Neni 11

Në Komunë përcaktohen mirënjohje dhe shpërblime komunale.

Neni 12

Komuna me vendim të miratuar nga Këshilli i Komunës mund të bashkohet në bashkësi në pajtim me Ligjin.

Neni 13

Komuna bashkëpunon me komunat e Republikës së Maqedonisë, me njësitë të vetadministrimit lokal të vëndeve tjera si dhe me organizata ndërkombëtare të bashkësive lokale. Komuna mundet të anëtarësohet në organizatat ndërkombëtare të pushteteve lokale.

Komuna me qëllim të realizimit interesave të përbashkëta dhe kryerjen e punëve të përbashkëta nga kompetenca e saj, mundet me komuna tjera të Republikës të bashkojë mjete dhe të formojë shërbime të përbashkëta publike në pajtim me ligj.

Neni 14

Komuna mundet me qytete të caktuara në vënd dhe jasht me të cilat vendos bashkëpunim t’i shpall komuna dhe qytete vëllazërore me Komunës e Dibrës.

Informimi i opinionit

Neni 15

Organet e Komunës si dhe trupat e punës së Këshillit dhe shërbimeve publike janë të obliguara që të informojnë qytetarët për punën dhe planet zhvëllimore të tyre si dhe tu mundësojnë marrjen e informacioneve në mënyrë të rregulluar me këtë Statut.

II. KOMPETENCAT E KOMUNËS

Neni 16

Komuna në mënyrë të mëvetësishme, në suazat e ligjit dhe këtij Statuti rregullon dhe kryen punët me interes publik me rëndësi lokale të përcaktuara me Ligjin për vetadministrim lokal ose ligj tjetër, si dhe punët të cilat nuk janë të përjashtuara nga kompetenca e saj ose nuk janë në kompetencë të organeve të administratës shtetërore.

Neni 17

Komuna është kompetente për kryerjen e këtyre punëve vijuese:

- 1. Planifikimin urbanistik (urban dhe rural), lëshimin e lejeve për ndërtim të objekteve më rëndësi lokale të përcaktuara me Ligj, rregullimin e hapësirës dhe rregullimin e tokës ndërtimore;***
- 2. Mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, në aspekt të marrjes së masave për mbrojtjen dhe pengimin e ndotjes së ujit, ajrit, tokës, mbrojtjen e natyrës, mbrojtjen nga zhurma dhe rrezatimi i pajonizuar;***
- 3. Zhvillimin ekonomik lokal, në aspekt të planifikimit të zhillimit ekonomik lokal, përcaktimin e prioriteteve zhvëllimore dhe strukturale, udhëheqjen e politikës ekonomike lokale, mbështetjen zhvëllimore të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe sipërmarrjeve në nivel lokal dhe në këtë kontekst në pjesëmarrjen dhe vendosjen e rrjetit të institucioneve dhe agjensive dhe promovimin e partneritetit;***
- 4. Veprimtaritë komunale, në aspekt të furnizimit me ujë të pijshëm, bartjes së ujit teknologjik, largimin dhe pastrimin e ujrave të zeza, largimin dhe trajtimin e ujrave atmosferik, ndriçimin publik, mirëmbajtjen e pastërtisë publike, mbledhjen, bartjen dhe zgjidhjen e mbeturinave të forta komunale dhe teknologjike, rregullimin dhe organizimin e transportit publik lokal të udhëtarëve, mirëmbajtjen e varrezave, varreve dhe dhënien e shërbimeve të varrimit, ndërtimin, mirëmbajtjen, rekonstruimin dhe mbrojtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave dhe objekteve tjera të infrastrukturës, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit të trafikut rrugor, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike për parkim, marrjen e automjeteve të parkuara jasht rregullit, ngritjen e automjeteve të papërdorura nga sipërfaqet publike, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve, pastrimin e oxhaqeve, mirëmbajtjen dhe përdorimin e parqeve, gjelbërimit, pyjeve parqe dhe sipërfaqeve rekreative, rregullimin, mirëmbajtjen dhe***

- shfrytëzimin e shtretërave të lumejve në pjesët urbane, përcaktimin e emrave të rrugëve, shesheve dhe objekteve tjera të infrastrukturës;*
- 5. Kulturën, në aspekt të mbështetjes institucionale dhe financiare të institucioneve dhe projekteve kulturore, kultivimit të folklorit, zakoneve, zejeve të vjetra dhe vlerave të ngjajshme kulturore, organizimit të manifestimeve kulturore, nxitjes së formave të shumëllojshme specifike të krijimtarisë;*
 - 6. Sportin dhe rekreimin, në aspekt të zhvillimit të sportit masiv dhe të aktiviteteve të rekreimit, organizimit të shfaqeve dhe manifestimeve sportive, mirëmbajtjes dhe ndërtimit të objekteve sportive, si dhe mbështetjen e lidhjeve sportive;*
 - 7. Mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve në aspekt të financimit, investimit, mirëmbajtjes dhe pronësisë të kopshteve fëmijërore dhe të shtëpive për pleq, realizimit të përkujdesjes sociale të personave invalid, të fëmijëve pa prindër dhe përkujdesjen prindore të fëmijëve me probleme edukativo-sociale, të fëmijëve me nevoja të veçanta, të fëmijëve me një prind si dhe të fëmijëve nga rruga, të personave të ekspozuar në rrezik social, të prekur me keqpërdorimin e drogës dhe alkoholit, ngritjen e vetëdijes së popullatës, familjarizimin të personave me rrezik social, realizimit të së drejtës dhe edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore;*
 - 8. Arsim, në aspekt të themelimit, financimit dhe administrimit të shkollave fillore dhe të mesme në bashkëpunim me pushtetin qendror në pajtim me ligjin si dhe organizimin e transportit dhe ushqimin e fëmijëve dhe vendosjen e tyre në konvikte;*
 - 9. Mbrojtjen shëndetësore në aspekt të udhëheqjes me rrjetin e organizatave shëndetësore publike dhe objekteve të mbrojtjes shëndetësore primare në të cilat komuna është e përfshirë në gjith Këshillat e organizatave shëndetsore në pronësi publike, edukimit shëndetësor, përparimit të shëndetësisë, aktiviteteve preventive, mbrojtjes së shëndetit të punëtorëve dhe mbrojtjes në punë, mbikqyrjes shëndetësore të ambijentit, mbikqyrjes së sëmundjeve ngjitëse, ndihmës së pacientëve më nevoja speciale si dhe lëmi të tjera të përcaktuara me ligj;*
 - 10. Zbatimin e përgatitjeve dhe marrjen e masave për mbrojtje dhe shpëtim të qytetarëve dhe të mirave materiale nga shkatërimet e luftrave, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera si dhe nga pasojat të shkaktura prej tyre;*
 - 11. Mbrojtjen kundër zjarrit që ushtrohet nga njësia territoriale e zjarfikësve;*

- 12. Mbikqyrjen ndaj ushtrimit të punëve nga kompetenca e komunës;**
13. punë tjera të caktuara me ligj.

Neni 18

Punët nga neni 17 të këtij Statuti, rregullohen me akte të Këshillit të Komunës në pajtim me procedurat dhe standartet të përcaktuara me ligj.

Punët nga neni 17 të këtij Statuti të cilat komuna obligativisht do ti ushtrojë do të përcaktohet me ligje të veçanta dhe programe nacionale.

Neni 19

Punët që nuk janë të përjashtuara nga kompetenca e Komunës ose që nuk janë në kompetencë të organeve të pushtetit shtetëror përcaktohen me vendim të Këshillit të komunës.

Me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni rregullohet mënyra dhe procedura për kryerjen e këtyre punëve.

**III. ORGANIZIMI DHE PUNA E
ORGANEVE TË KOMUNËS**

Neni 20

Organe të Komunës janë: Këshilli dhe Kryetari.

1. Këshilli i Komunës

Neni 21

Këshilli i Komunës është organ përfaqësues i qytetarëve.

Këshillin e komunës e përbëjnë 15 përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë.

Mandati i anëtarëve të këshillit zgjat 4 (katër) vite.

Anëtari i Këshillit nuk mund të revokohet.

Neni 22

Këshilli i komunës, nga rradhët e anëtarëve të Këshillit zgjedh kryetar me mandat prej katër vitesh.

Kryetari i këshillit i konvokon dhe udhëheq me seancat e Këshillit të komunës, kujdeset për organizimin dhe punën e Këshillit, nënshkruan aktet që i ka miratuar Këshilli dhe në afat prej 3(tre) ditësh nga dita e miratimit ia dërgon Kryetarit të Komunës për shpallje.

Neni 23

Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë dhe detyrë të jenë të pranishëm dhe të marrin pjesë në punën e Këshillit dhe të trupave të tij të punës.

Anëtarët kanë të drejtë në seancën e Këshillit të japin propozime e iniciativa si dhe të parashtrojnë pyetje Kryetarit të Komunës.

Anëtari i Këshillit nuk mund të thirret në përgjegjësi penale ose të ndalohet për mendimin e shprehur ose për votimin në Këshillin e Komunës.

Neni 24

Punëdhënësi është i obliguar që të lirojë këshilltarit nga puna profesionale gjatë mbajtjes së seancave të Këshillit dhe trupave të punës.

Neni 25

Anëtarit të Këshillit i pushon mandati para kalimit të kohës për të cilën është zgjedhur:

- nëse jep dorëheqje,**
- në rast vdekje,**
- nëse është i dënuar me vendim të plotfuqishëm për vepër penale me dënim në kohëzgjatje mbi 6 muaj,**
- në rast të mospërputhjes të funksionit anëtar i Këshillit sipas Ligjit për zgjedhje lokale,**
- nëse me vendim të plotfuqishëm humb aftësinë e punës,**
- nëse pushon të jet qytetar i Komunës.**

Këshilli, në seancën e parë do të konstatojë arsyen dhe ditën i pushimit të mandatit të anëtarit të Këshillit, dhe atë:

- në rastet nga paragrafi 1 pika 1, nga dita e mbajtjes së seancës dhe**
- në rastet nga paragrafi 1 pikat 2,3,4,5 dhe 6 nga dita e plotësimit të kushtit.**

Anëtarit të Këshillit mund t'i merret mandati nëse pa arsye mungon tre seanca radhas.

Për arsyetueshmërinë e mungesës nga paragrafi 3 i këtij neni Këshilli vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Neni 26

Anëtarët e Këshillit japin dhe nënshkruajnë deklaratë solemne me këtë përbajtje:

“Unë (emri dhe mbiemri) solemnisht deklaroj se të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Këshillit do t'i kryej me ndërgjegje dhe se gjatë kryerjes së tyre do ta respektoj Kushtetutën, ligjin statutin, vendimet e Këshillit si dhe do ta mbroj rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë.

Neni 27

Këshilli i Komunës kryen këto punë:

- 1. Sjell statut të Komunës;**
- 2. Sjell rregullore të Këshillit;**
- 3. Sjell program të punës;**
- 4. Miraton buxhetin të komunës dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit.**
- 5. Përcakton lartësinë e tatimeve dhe lartësinë e kompensimeve e taksave;**
- 6. Sjell plan të përgjithshëm urbanistik;**
- 7. Sjell plane detale urbanistike dhe dokumentacion urbanistik për vendbanimet në Komunë.**
- 8. Sjell program për rregullimin e tokës ndërtimore.**
- 9. Sjell program për mirëmbajtjen e sinjalizimit të komunikacionit;**
- 10. Miraton vendim për rregullimin e rregjimit të komunikacionit;**
- 11. Sjell dispozita nga fusha e mbrojtjes së mjedisit dhe natyrës, zhvillimit ekonomik lokal, kulturës, sportit dhe rekreimit, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, arsimit, mbrojtjes shëndetsore, mbrojtjes nga zjarri në suazat e kompetencës së përcaktuar me ligj të veçantë ose në pajtim me programin nacional,**
- 12. Sjell program për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave;**
- 13. Sjell program për ndriçimin publik;**
- 14. Sjell program për ndërtimin, rindërtimin dhe mirëmbajtjen e ujësjellësve lokale,**
- 15. Sjell program për mirëmbajtjen e pastërtisë publike,**
- 16. Sjell program për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e parqeve dhe të sipërfaqeve të tjera publike me rëndësi lokale;**
- 17. Sjell program për mirëmbajtjen e varrezave të qytetit;**
- 18. Sjell program për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e lumejve në territore të urbanizuara;**
- 19. Miraton vendim për pastërtinë publike;**
- 20. Miraton vendim për mënyrën e transportit në komunikacionin urban dhe ndërrurban;**
- 21. Miraton vendim për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tregjeve publike.**

22. Miraton vendim për mirëmbajtjen e varrezave dhe mënyrën e shfrytëzimit;
23. Rregullon mënyrën e pastrimit të oxhaqeve;
24. Rregullon mirëmbajtjen e hapsirës publike për parkim dhe mënyrën e shfrytëzimit të saj;
25. Përcakton emra të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera të infrastrukturës me rëndësi lokale
26. E përcakton organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës komunale, më propozim të kryetarit;
27. Themelon shërbime publike dhe kryen kontrollin ndaj punës së tyre;
28. Emëron anëtarë në këshillat drejtues të shërbimeve publike që i themelon;
29. Miraton programe pune dhe plane financiare për financim të shërbimeve publike që i themelon;
30. Vendos për dhënien e lejes për kryerjen e veprimtarisë me interes publik me rëndësi lokale ;
31. Miraton raportet e punës dhe llogaritë përfundimtare të shërbimeve publike që i ka themeluar;
32. Vendos për mënyrën e disponimit me pasurinë e komunës;
33. Vendos për mënyrën e kryerjes së kontrollit financiar të buxhetit të komunës ne pajtim me ligj;
34. Zgjedh personin që udhëheq me njësinë rajonale të Ministrisë për Punë të Breshme në Komunë në pajtim me ligj;t;
35. Shqyrton dhe miraton raportin vjetor për sigurinë publike në territorin e komunës që e dërgon Ministrit për Punë të Breshme dhe Avokatit popullor;
36. Mund të jep rekomandime personit udhëheqës të njësisë rajonale të Ministrisë për punë të Breshme nga fusha e sigurisë publike dhe sigurisë së komunikacionit;
37. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin e Këshillit;
38. Formon komisione të përhershme dhe të përkohshme;
39. Ushtron autorizime të veçanta në pajtim me ligj ndaj të mirave në përdorim të përgjithshëm dhe ndaj pasurive natyrore në territorin e komunës;
40. Përcakton mirënjohje dhe dhurata komunale;
41. Jep mendim për propozim ligjet që kanë të bëjnë me komunën;
42. Bën zgjedhje dhe emërimet tjera nga kompetenca e vet;
43. Sjell vendime tjera për punët nga kompetenca e vet;
44. Kryen dhe punë të tjera.

Neni 28

Këshilli i komunës vendos me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit, e së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, nëse me statut nuk është paraparë shumicë e veçantë.

Votimi në seancat e Këshillit është i hapur, përpos në rastet kur Këshilli vendos që për çështje të caktuara votimi të jetë i fshehtë.

Dispozitat që kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhëve dhe shkrimeve në të cilat flasin së paku 20% të qytetarëve të komunës, përcaktimin dhe përdorimin e stemës dhe flamurit të komunës, miratohen me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në ç'rast duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit që i përkasin bashkësive që nuk janë shumicë popullatë në komunë.

Neni 29

Seancë e jashtëzakonshme konvokohet për çështjet me rëndësi për sigurinë e qytetarëve, për çështjet e krijuara për shkak të situatave të jashtëzakonshme (zjar, vërshime, termete e ngj.) si dhe gjatë vizitës së delegacionit të shtetit të huaj e cila dëshiron t'u drejtohet anëtarëve të Këshillit.

Neni 30

Seancën e jashtëzakonshme e konvokon kryetari i Këshillit me iniciativë të vet, me propozim të së paku 1/3 të anëtarëve të Këshillit ose me propozim të Kryetarit.

Ftesa për seancë me propozim rendin e ditës u dërgohet anëtarëve të Këshillit në mënyrën më të shpejtë të mundshme.

Para fillimit me punë anëtarët e Këshillit votojnë për arsyetueshmërinë e shkaqeve të konvokimit të seancës pa diskutim material.

Neni 31

Për shqyrtimin e çështjeve nga kompetenca e vet Këshilli formon komisione. Komisionet e Këshillit formohen si të përhershëm dhe të përkohshëm.

Mandati i trupave të përhershëm të punës zgjat sa edhe mandate i anëtarëve të Këshillit.

Neni 32

Komisione të përhershme të Këshillit të Komunës janë:

- Komisioni për financa, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal;***
- Komisioni për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës;***
- Komisioni për veprimtari shoqërore;***
- Komisioni për statut dhe dispozita;***

- *Komisioni për çështjet e mandatit, zgjedhjeve dhe emërimeve;*
- *Komisioni për marrëdhëniet me bashkësitë.*

Komisionit përbëhen prej 5 anëtarëve të Këshillit .

Neni 33

Komisioniet e Këshillit të Komunës:

- *diskutojnë për çështje nga sferat për të cilin janë formuar,*
- *i japin mendime dhe propozime Këshillit,*
- *shqyrtojnë propozimet e kryetarit të Komunës, të anëtarëve të Këshillit dhe iniciativat e qytetarëve nga sfera për të cilin janë formuar.*

Neni 34

Komisioni për financim, buxhet dhe zhvillim ekonomik lokal shqyrton çështjet lidhur me financimin e Komunës, buxhetin dhe llogarinë përfundimtare si dhe çështjet e planifikimit dhe programimit të zhvillimit ekonomik lokal.

Neni 35

Komisioni për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës shqyrton çështjet e planifikimit urbanistik, çështjet nga puna e shërbimeve publike, çështjet e rregullimit të komunaleve në qytet dhe vendbanime, si dhe çështjet e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe natyrës.

Neni 36

Komisioni për veprimtari shoqërore shqyrton çështjet nga kompetenca e komunës që kanë të bëjnë me kulturën, sportin dhe rekreimin, mbrojtjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve, arsimin, mbrojtjen shëndetsore, sigurinë publike dhe sigurinë në komunikacion si dhe mbrojtjen nga zjarri.

Neni 37

Komisioni për statut dhe dispozita përcakton propozim statutin e komunës, shqyrton iniciativat dhe propozimet për ndryshimin e statutit, përcjell zbatimin e statutit dhe shqyrton çështjet parimore me karakter statutar, verifikon propozimin e rregullores të Këshillit, përgatit propozim mendime për propozim ligjet që i përkasin komunës, shqyrton edhe akte tjera të përgjithshme nga kompetenca e Këshillit të Komunës.

Neni 38

Komisioni për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërime shqyrton dhe përgatit propozime të cilat u përkasin çështjeve të mandatit dhe imunitetit, shqyrton dhe përgadit propozime për zgjedhje, emërime dhe shkarkime të cilat

janë në kompetencë të Këshillit të Komunës, cakton rroga, kompensime dhe të ardhura tjera të personave të zgjedhur dhe emëruar, jep propozim për lartësinë e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit dhe të mëditjeve të anëtarëve të Këshillit të Komunës dhe lartësinë e shpenzimeve të kryera gjatë ushtrimit të detyrave që u ka besuar Këshilli i komunës.

Kryetarin dhe anëtarët e komisionit i zgjedh Këshilli i Komunës në seancën e saj të parë.

Neni 39

Komisioni për marrëdhënie ndërmjet bashkësive shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet mes bashkësive të përfaqësuara në Komunë dhe jep mendime dhe propozime për mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Komisioni përbëhet prej numrit të barabartë të përfaqësuesve të çdo bashkësie të përfaqësuar në Komunë.

Neni 40

Kryetarin dhe anëtarët e komisioneve i zgjedh Këshilli i komunës sipas propozimit të komisionit për çështje mandatore, zgjedhje, dhe emërimë.

Propozimi për zgjedhje përmban aq kandidatë sa anëtarë zgjedhën në trupat e punës.

Partitë politike që participojnë në Këshillin e komunës do të përfaqësohen në mënyrë proporcionale në numrin e përgjithshëm të anëtarëve në të gjithë komisionet.

Neni 41

Mënyra e punës së trupave të punës më afër rregullohet me Rregulloren e punës të këshillit të Komunës.

2. Kryetari i komunës

Neni 42

Kryetari i komunës përfaqëson dhe prezenton Komunën.

Kryetari i komunës zgjedhet në zgjedhje të përgjithshme të drejpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë në pajtim me ligjin për periudhë prej 4 vjetësh.

Kryetari e kryen funksionin e tij në mënyrë profesionale.

Funksioni kryetar është inkompatibil me funksion tjetër.

Neni 43

Kryetari i komunës gëzon imunitet.

Neni 44

Kryetari i Komunës në suaza të autorizimeve të veta:

- **propozon Këshillit të Komunës miratimin e akteve tjera të cilat janë në kompetencë të Këshillit të komunës;**
- **siguron ekzekutimin e punëve të cilat i janë deleguar nga organi i administratës shtetërore;**
- **propozon Buxhetin vjetor dhe llogarinë përfundimtare të buxhetit të Komunës;**
- **realizon buxhetin e Komunës;**
- **vendos në punë administrative për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e personave juridik dhe fizik, në pajtim me ligj;**
- **udhëheq me administratën komunale;**

- **sjell rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale;**
- **vendos për punësimin, të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në administratën komunale, nëse në mënyrë tjetër nuk është përcaktuar me ligj;**
- **kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe me këtë Statut.**

Kryetari i komunës ka të drejtë të jet i pranishëm dhe të merr pjesë në punën e seancave të Këshillit.

Neni 45

Kryetari shpall aktet e Këshillit në kumtesën zyrtare të komunës.

Kryetari siguron ekzekutimin e vendimeve të Këshillit.

Neni 46

Kryetari është i detyruar në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së aktit të Këshillit, me aktvendim të pezullojë shpalljen e saj nëse konsideron se nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ligjet.

Ekzemplar i aktvendimit të arsyetuar për mosshpallje i dërgohet kryetarit të Këshillit të komunës.

Këshilli është i obliguar, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e shpalljes së aktvendimit ta shqyrtojë ose të vendosi rreth saj.

Nëse Këshilli verifikon aktin ose nuk debaton në afatin nga paragrafi 3 i këtij neni, Kryetari është i obliguar që aktin ta shpalli dhe njëkohësisht të merr iniciativë për hapjen e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë të aktit të kontestuar para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

Për iniciativën Kryetari është i obliguar të informojë Ministrinë kompetente për kryerjen e punëve që kanë të bëjnë me vetadministrimin lokal.

Neni 47

Kryetari është i obliguar të paraqesi raport për ekzekutimin e vendimeve të miratuara nga Këshilli i Komunë ç'do 3 (tre) muaj gjatë vitit.

Për realizimin e kompetencave të veta Kryetari i komunës informon Këshillin sipas nevojës e së paku 2 (dy) herë ne vit.

Neni 48

Kryetari udhëheq me pasurinë e komunës si nikoqir i mirë.

Në udhëheqjen e pasurisë së komunës kryetari është i detyruar të marrë masa dhe të sigurojë shfrytëzimin e pasurisë në pajtim me ligj.

Neni 49

Gjatë kohës së pengesës ose mungesës deri në gjashtë muaj kryetarin e zëvendëson anëtar i Këshillit të Komunës të cilin e cakton ai.

Në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e marrjes se funksionit Kryetari është i obligur me aktvendim të përcaktojë anëtarin e Këshillit i cili do ta zëvendësojë.

Aktvendimi nga paragrafi 2 shpallet në Kumtesën zyrtare të komunës.

Për ditën e paraqitjen së pengesës osë mungesës Kryetari i Komunës njofton kryetarin e Këshillit.

Gjatë kohës së zëvendësimit të kryetarit anëtarit të Këshillit të komunës i pushon funksioni i anëtarit të Këshillit.

Anëtari i Këshillit i cili pranon funksionin e Kryetarit të komunës ka të drejtë të merr pjesë në debatet në seancat e Këshillit pa të drejtë vote.

Neni 50

Kryetarit të Komunës i pushon mandati:

- sipas fuqisë ligjore;***
- në rast vdekje;***

- nëse jep dorëheqje dhe raste tjera të parapara me ligj.

Këshilli për mbrojtje të konsumatorëve

Neni 51

Këshilli i komunës për shqyrtim të çështjeve dhe verifikim të propozimeve të cilat kanë të bëjnë me kualitetin e punëve të shërbimeve publike të themeluara prej tij, mund të formojë Këshill për mbrojtje të konsumatorëve.

Neni 52

Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve është i përbërë prej 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) zgjidhen nga rradhët personave juridik dhe 4 (katër) anëtarë nga personat fizik, si shfrytëzues të shërbimeve që i japin shërbimet publike.

Anëtarët e Këshillit për mbrojtje të konsumatorëve zgjidhen me propozim të Komisionit për çështje mandatore, zgjedhje dhe emërimë.

Mandati i anëtarëve zgjat 2 (dy) vite me mundësi për rizgjedhje.

Neni 53

Këshilli për mbrojtje të konsumatorëve përcjell gjendjen e kualitetit të shërbimeve që japin shërbimet publike, jep mendime dhe propozime për përmirësimin e kualitetit të shërbimeve, organizon tribuna publike, bashkëpunon me shërbimet publike dhe administratën komunale.

IV. ADMINISTRATA KOMUNALE

Neni 54

Për kryerjen e punëve nga kompetenca e organeve të komunës organizohet administrata komunale.

Administrata komunale organizohet si seksione dhe sektore .

Komuna mund të organizojë inspektorat komunal për ushtrimin e mbikqyrjes të inspektimit në lidhje me kryerjen e punëve nga kompetenca e saj.

Kryetari i Komunës me propozim të Agjensionit për Nëpunësit Shtetëror, me vendim do të përcaktojë përkatësinë e titujve ekzistues në komunë me grupet dhe titujt e përcaktuar me Ligjin për nëpunësit shtetëror.

Organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës komunale e përcakton, Këshilli me propozim të Kryetarit të Komunës.

Neni 55

Të punësuarit në administratën komunale të cilët kryejnë punë profesionale, normative – juridike, ekzekutive, administrative- mbikqyrëse dhe vendosin punë administrative kanë status të nëpunësit shtetëror.

Për punësimin, të drejtat dhe obligimet, sistemin e rrogave dhe kompensimet të rrogave, përgjegjësinë dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës të të punësuarve nga paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohen dispozitat e Ligjit për nëpunësit shtetëror.

Për të punësuarit në administratën komunale që kryejnë punë administrative-teknike dhe punë ndihmëse do të zbatohen dispozitat e ligjislativës punuese.

Neni 56

Gjatë punësimit në administratën komunale dhe në shërbimet publike të cilat i ka themeluar Komuna, do të mbahet llogari për përfaqësim të drejtë dhe përkatës të qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësive të përfshira në komunë në të gjitha nivelet, si dhe për respektimin e kriterëve të profesionalizmit dhe kompetencës.

Neni 57

Administrata komunale:

- ***përgatit akte për Këshillin dhe Kryetarin e Komunës;***
- ***përgatit seancat e Këshillit si dhe mbledhjet e komisioneve të përhershme dhe të përkohshme;***
- ***kryen punë profesionale për Këshillin dhe Kryetarin e komunës;***
- ***përcjell problematikën në fushat nga kompetenca e Komunës, bën analiza për gjendjen dhe jep iniciativa dhe propozime për zgjidhjen e tyre;***
- ***jep informata dhe të dhëna në lidhje me aktivitetet e komunës me kërkesë të organeve kompetente ose në mbështetje të ligjit;***
- ***i përdor dokumentet e komunës dhe i rruan ata derri në azgjesimin gjegjësisht dorëzimin në Arkivin Shtetëror të Republikës së Maqedonisë;***
- ***kryen dhe punë të tjera që do t'ia përcakton Këshilli dhe Kryetari i komunës.***

V. AKTET E ORGANEVE TË KOMUNËS

a) Aktet e përgjithshme

Neni 58

Statuti është akt themelor i Komunës me të cilin rregullohen çështjet themelore lidhur me kompetencat dhe organizimin e komunës dhe çështjet të tjera me rëndësi për komunën.

Statuti i Komunës sjellet në 2 faza dhe atë si projektstatut dhe propozim statut.

Statutin e Komunës e miraton Këshilli me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Komunës.

Neni 59

Këshilli i Komunës miraton rregullore të punës së Këshillit, vendime, plane dhe programe, aktvendime, përfundime dhe akte të tjera, jep mendime dhe përcakton orientime.

Neni 60

Me rregulloren e punës së Këshillit rregullohet mënyra e punës së Këshillit të Komunës dhe komisioneve të saja, procedura e vendosjes dhe marrëdhëniet me organet e tjera.

Rregullorja e punës së Këshillit të Komunës miratohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Komunës.

Neni 61

Me vendim të Këshillit rregullohen punët me rëndësi lokale në kompetencë të Komunës.

Me vendim të Këshillit të Komunës themelohet administrata komunale dhe rregullohet mënyrën e punës së saj si dhe themelohen shërbimet publike.

Me vendim Këshilli rregullon edhe çështje të tjera nga kompetenca e saj.

Neni 62

Këshilli miraton përfundime kur shqyrton raporte, informata dhe analiza të veçanta.

Këshilli jep mendime dhe përcakton orientime për zbatimin e dispozitave dhe të akteve të tjera që i miraton Këshilli i Komunës.

Neni 63

Procedura e miratimit të akteve të përgjithshme rregullohet me rregulloren e punës së Këshillit të Komunës.

Aktet e përgjithshme dhe aktet tjera publikohen në Kumtesën zyrtare të Komunës.

Aktet e përgjithshme hyjnë në fuqi ditën e 8 (tetë) prej ditës së shpalljes, por sipas përjashtimit që e përcakton Këshilli i Komunës ditën e miratimit.

b) Akte individuale

Neni 64

Këshilli dhe Kryetari në suazat e kompetencave të veta miratojnë akte individuale.

Këshilli miraton aktvendime për zgjedhje dhe emërimë.

Kryetari miraton aktvendime.

Neni 65

Kryetari i komunës është i obliguar që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të akteve t'i shpalli ata në Kumtesën zyrtare të komunës.

Neni 66

Për aktet e shpalluar mbahet përmbledhje e veçantë.

Përmbledhjen mund ta shfrytëzojnë qytetarët dhe e njejta do të jetë në disponim në çdo kohë.

**VI. FORMAT E PJESËMARRJES SË DREJTPËRDREJTË
TË QYTETARËVE NË VENDOSJE NË KOMUNË**

a) Iniciativë qytetare

Neni 67

Qytetarët kanë të drejtë t'i propozojnë Këshillit të komunës të miratojnë akt konkret ose të zgjidhë çështje të caktuara nga kompetenca e vet.

Këshilli është i detyruar në afat prej 90 ditësh të diskutojë për iniciativën e qytetarëve nëse ate e mbështesin së paku 10% e zgjedhësve të komunës.

Mbështetja nga paragrafi 2 i këtij neni sigurohet me nënshkrimet e qytetarëve.

Për vendimet e marra në lidhje me iniciativën e paraqitur Këshilli informon qytetarët.

Iniciativa qytetare nuk mund të paraqitet për çështje kadrovike dhe financiare.

b) Tubimi i qytetarëve,

Neni 68

Tubim të qytetarëve thëret Kryetari i Komunës me iniciativë të vet, me kërkesë të Këshillit ose kërkesë të së paku 10% të zgjedhësve të Komunës gjegjësisht vetqeverisjes së vendit për të cilin ka të bëjë çështja e caktuar.

Tubimi i qytetarëve mund të thiret për tërë territorin e komunës ose për një pjesë të vetqeverisjes së vendit.

Kryetari i komunës është i detyruar në afat prej 30 ditësh të thëras tubim të qytetarëve me kërkesën e së paku 10% të zgjedhësve në komunë ose të vetqeverisjes së vendit të cilës i përket çështja e caktuar.

Kërkesa për thirjen e tubimit të qytetarëve me nënshkrimet e qytetarëve të interesuar i paraqitet kryetarit të komunës.

Akti i thirjes të tubimit të qytetarëve shpallet në mjetet lokale të informacionit dhe në vende publike në mënyrë të rëndomtë.

Prej ditës së shpalljes, gjegjësisht vënies së aktit për thirjen e tubimit të qytetarëve deri në ditën e mbajtjes të tubimit duhet të kalojnë së paku 5 ditë.

Neni 69

Në tubimin e qytetarëve të drejtë në vendosje kanë qytetarët me të drejtë vote.

Tubimin e qytetarëve e udhëheq Kryetari i Komunës ose person që do ta autorizojë ai.

Për çështjet për të cilat diskutohet në tubimet e qytetarëve informon Kryetari i Komunës e sipas nevojës edhe përfaqësues të tjerë të autorizuar të administratës komunale.

Neni 70

Përfundimet e miratuara në tubimin e qytetarëve organet e komunës janë të obliguar që në afat prej 90 ditësh t'i shqyrtojnë dhe t'i marrin parasysh gjatë vendosjes dhe marrjes së masave rreth çështjeve për të cilat kanë të bëjnë si dhe t'i informojnë qytetarët për vendimet e marra.

6)Referendumi.

Neni 71

Referendum mund të shpall Këshilli i komunës me iniciativë të vet për çështje nga kompetenca e tij.

Këshilli është i detyruar të shpallë referendum me kërkesën e së paku 20% të zgjedhësve.

Kërkesa për shpalljen e referendumit i dërgohet Këshillit të komunës me nënshkrime të zgjedhësve të interesuar të dhëna para organit kompetent i cili mban evidencë për të drejtën zgjedhore të qytetarëve të komunës.

Neni 72

Mbi kërkesën për shpalljen e referendumit Këshilli i Komunës në afat prej 60 ditësh prej paraqitjes së kërkesës miraton vendim për shpalljen e referendumit.

Vendimi mbi shpalljen e referendumit përmban lëndën e cila është objekt i referendumit dhe ditën e mbajtjes të saj.

Neni 73

Vendimi mbi shpalljen e referendumit shpallet në Kumtesën zyrtare dhe mjetet tjera të informacionit në komunë.

Prej ditës së nxjerjet të vendimit mbi shpalljen e referendumit deri në ditën e mbajtjes së referendumit nuk mund të kalojnë më pak se 15 ditë as më shumë se 60 ditë.

Neni 74

Të drejtë votimi në referendum kanë qytetarët të cilët kanë të drejtë zgjedhore.

Referendumin e realizon komisioni për realizimin e referendumit.

Kryetarin dhe anëtarët e komisionit i emëron Këshilli i komunës.

Neni 75

Komisioni për realizimin e referendumit

- cakton kohën e votimit;***
- bën përgatitje teknike për rrealizimin e referendumit;***
- cakton vendvotimet;***
- vërteton rezultatet e votimit dhe***
- kujdeset për zbatimin ligjor të referendumit.***

Neni 76

Për realizimin e votimit të referendumit, komisioni për vendvotimet formon këshilla për realizimin e referendumit.

Këshillat sigurojnë rregullsinë dhe fshehtësinë e votimit.

Neni 77

Koha e votimit duhet të caktohet ashtu që t'u mundësojë pjesmarrje në referendum të gjithë qytetarëve me të drejtë vote.

Në vendvotimin në të cilën kanë votuar të gjithë qytetarët e regjistruar në listën zgjedhore, votimi mund të mbyllet edhe para kalimit të kohës së caktuar për votim.

Neni 78

Çështja gjegjësisht akti që është objekt e referendumit duhet patjetër të jetë ekspozuar në mënyrë gjegjëse në vendin e votimeve.

Anëtarët e Këshillit janë të detyruar qytetarit që voton, me kërkesën e tij t'i japin sqarime për lëndën e referendumit dhe për mënyrën e votimit.

Neni 79

Në referendum sejcili qytetar ka të drejtë vetëm në një votë.

Qytetari mund të votojë vetëm personalisht.

Neni 80

Në referendum votohet me fletëvotime.

Përmbajtjen e fletëvotimeve e cakton komisioni për zbatimin e referendumit.

Pyetja në fletëvotim duhet të jetë e formuluar saktësisht dhe jodykuptimshëm, ashtu që qytetari në referendum të mund të përgjigjet me "PËR" ose "KUNDËR" propozimit.

Neni 81

Qytetari në referendum shprehet ashtu që në fletën e votimit e rrethon fjalën "PËR" ose "KUNDËR".

Kur në referendum janë shtruar disa alternativa, qytetari shprehet ashtu që e rrethon fjalën "PËR" ose "KUNDËR" të alternativës për të cilën ka votuar.

Neni 82

Pas kryerjes së votimit këshilli vërteton rezultatin e votimit për vendvotimin dhe për këtë përpilon procesverbal.

Formën dhe përmbajtjen e procesverbalit e cakton komisioni për zbatimin e referendumit.

Menjëherë pas përpilimit të procesverbalit Këshilli i dërgon raport komisionit për zbatimin e referendunit.

Neni 83

Komisioni për zbatimin e referendunit në bazë të materialit të pranuar të votimit nga të gjitha vendvotimet verifikon rezultatin e votimit.

Në referendum miratohet vendim me shumicën e votave të zgjedhësve të cilat kanë votuar, nëse kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të zgjedhësve.

Vendimi i miratuar në referendum është i detyrueshëm për Këshillin.

Komisioni për zbatimin e referendunit i paraqet raport Këshillit të Komunës për referendumin e realizuar.

Neni 84

Çështja respektivisht akti që qytetarët nuk e kanë mbështetur në referendum nuk mundet përsëri të paraqitet në referendum para kalimit të 6 muajve prej ditës të mbajtjes të referendunit.

ç) Parashtrësia dhe propozime

Neni 85

Për punën e organeve të Komunës dhe administratës komunale, qytetarët kanë të drejtë, individualisht ose bashkarisht me të tjerë të dërgojnë parashtrësia dhe propozime.

Neni 86

Parashtrësat dhe propozimet në mënyrë individuale ose në grup i paraqiten Kryetarit të komunës në formë me shkrim ose gojarisht në procesverbal.

Për parashtrësat dhe propozimet nuk paguhet taksë.

Neni 87

Parashtruesi nuk guxon të pësojë konsekuenca për shkat të paraqitjes së parashtrësës, as që mund të thuret në përgjegjësi për ate.

Neni 88

Procedimi rreth parashtrësive dhe propozimeve përfshin grumbullimin e të dhënave, njoftimeve dhe mendimeve për rrethanat që janë me rëndësi për vlerësim të drejtë të parashtrësës, si dhe marrjen e masave të nevojshme për

menjanimin e shkeljes të së drejtës të parashtruesit ose shkeljes të interesave publike.

Neni 89

Kryetari i komunës është i obliguar më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimi të parashtrësës gjegjësisht propozimit, parashtruesit t'i dërgojë përgjigje të arsyetuar.

Nëse parashtrësja ose propozimi nuk ka të bëjnë me punën në kompetencë të organeve të Komunës, Kryetari i komunës e përcjell te organi përkatës kompetent dhe për këtë e njofton parashtruesin.

d)Tribuna publike, anketa dhe propozime.

Neni 90

Organet e komunës, gjatë miratimit të dispozitave nga kompetenca e vet paraprakisht mund të organizojnë tribuna publike, të zbatojnë anketa ose të kërkojnë propozime nga qytetarët.

Tribunë publike organizohet kur miratohen dispozita për çështje të zhvillimit ekonomik lokal, nevoja komunale (furnizim me ujë, mirëmbajtje të pastërtisë

publike, mirëmbajtje të rrugëve lokale dhe rrugicave) si dhe çështjeve tjera me rëndësi më të gjërë lokale.

Anketa zbatohet për sjellje të planeve urbanistike dhe çështje tjera me rëndësi lokale.

Grumbullimi i propozimeve nga qytetarët për zgjidhjen e punëve me rëndësi lokale, do të kryhet nëpërmjet shpalljes të njoftimeve më të cilat do të thirren qytetarët që të japin propozimet e tyre.

Procedura, mënyra dhe koha e marrjes së njerit nga aktivitetet të theksuara në paragrafin e parë të këtij neni, do të rregullohet me vendim miratuar nga organi që ka organizuar ato.

VII. PRONA E KOMUNËS

Neni 91

Pronën e komunës e përbëjnë sendet e patundshme dhe të tundshme, mjetet në para dhe të drejtat.

Komuna krijon pasurinë nga burimet e veta të të hyrave, nëpërmjet financimit nga ana e qytetarëve ose me pjesmarrjen e tyre në mënyrë tjetër, nga dhuratat dhe baza të tjera.

Neni 92

Për blerjen, tjetërsimin dhe ngarkesën e pronës së komunës vendos Këshilli i Komunës.

Tjetërsimi i pronës së Komunës bëhet vetëm nëpërmjet ankandit publik, në pajtim me ligj.

Çmimi i shitjes së mjeteve nuk guxon të jet më i vogël se vlera e tyre e tregut.

Mjetet e fituara nga shitja e sendeve mund të investohen vetëm për krijimin ose rekonstruimin e mjeteve ekzistuese në pronësi të komunës.

Neni 93

Komuna evidenton pronën e vet dhe bilanci i saj paraqitet në llogarinë vjetore.

Neni 94

Sendet në pronë të Komunës mund të jepen në përdorim subjektëve tjerë nëpërmjet ankandit publik, në pajtim me ligj.

Neni 95

Komuna financohet nga burimet e veta të të ardhurave,tatimeve, kompensimeve dhe taksave lokale të përcaktuara me ligj,dotacioneve nga shteti dhe burimeve tjera të përcaktuara me ligj.

Komuna në suazat e kompetencave të veta, pavarësisht disponon me të hyrat burimore vetanake.

Neni 96

Të hyrat dhe shpenzimet e komunës përcaktohen me buxhetin e komunës.

Buxheti i komunës përmban bilancin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit që i përket vitit fiskal prej 12 muajsh, i cili fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të ç'do viti kalendarik.

Neni 97

Propozim buxhetin e komunës e verifikon Kryetari dhe ia dërgon Këshillit të Komunës për miratim më së voni deri në mesin e muajit nëntor.

Këshilli i komunës nuk mund ta shqyrtojë propozim buxhetin e komunës para kalimit të 20 (njëzet) ditëve nga dita e dërgimit këshilltarëve të Këshillit të komunës.

Neni 98

Për ç'do ndryshim të Buxhetit të Komunës, për shpenzimet e miratuara plotësuese të përcjella me masat që do të risin të hyrat e parapara ose zvogëlojnë shpenzimet në proporcionin e njëjtë, vendim miraton Këshilli i Komunës.

Neni 99

Për mbulimin e kërkesave të paparashikuara të shpenzimeve që do të paraqet gjatë vitit buxhetor, nga shpenzimet e përgjithëshme vijuese dhe kapitale ndahet rrezerva buxhetore në lartësinë e pacaktuar me ligj.

Për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore vendos Këshilli i Komunës në bazë të propozimit të kryetarit të Komunës.

Këshilli i Komunës me vendim mund të autorizojë Kryetarin e komunës për mënyrën e shfrytëzimit të rezervës buxhetore.

Neni 100

Nëse buxheti i komunës për vitin e ardhshëm nuk miratohet deri më 31 dhjetor të vitit vijues, do të veprohet në pajtim me Ligjin mbi buxhetet dhe do të aplikohet financimi i përkohshëm, dhe ate më së shumti për gjashtë muaj.

Neni 101

Në fund të çdo viti fiskal përpilohet llogaria përfundimtare e buxhetit të Komunës.

Llogarinë përfundimtare të buxhetit për vitin paraprak, Këshilli i Komunës duhet të miratojë më së voni deri më 31 mars të vitit vijues.

Neni 102

Realizimin e buxhetit të komunës e bën Kryetari, që më konkretish rregullohet me vendimin për realizimin e buxhetit të Komunës.

VIII. VETQEVERISJA VENDORE NË KOMUNË

Neni 103

Qytetarët në komunë vendosin edhe për punët me rëndësi të drejtëpërdrejtë dhe të përditëshme për jetën dhe punën e tyre nëpërmjet të formave të vetqeverisjes vendore, të cilat mund t'i themelojnë në pajtim me këtë statut.

Neni 104

Në Komunë si formë e vetqeverisjes vendore mund të themelohen - bashkësi urbane për qytetin dhe bashkësi vendore për vendbanimet tjera .

Neni 105

Forma e vetadministrimit vendor themelohen, në qytet për njësi urbane në pajtim me planin urbanistik, kurse për vendbanimet tjera të komunës kadastrale në vendbanimin.

Neni 106

Iniciativë për themelimin e formave të vetadministrimit vendor mund të paraqesin së paku 10% të qytetarëve banor të territorit ku ka interes për themelimin e formës së vetqeverisjes vendore.

Neni 107

Iniciativa për themelim përmban: inicuesin, përkrahimin e territorit për të cilin kërkohet themelimi i formës së vetadministrimit vendor, arsyetimin e nevojave të themelimit dhe nënshkrimin e qytetarëve të interesuar.

Iniciativa për themelim i dërgohet Këshillit të Komunës i cili shqyrton dhe vlerëson nëse kërkesat janë të bazuara dhe janë plotësuar kushtet për themelimin e formës të vetadministrimit të vendor.

Neni 108

Vendimi për themelimin e formës së vetadministrimit vendor miratohet na Tubim të qytetarëve të territorit përkatës me votim publik me shumicë votash të qytetarëve të pranishëm.

Neni 109

Qytetarët nëpërmjet vetadministrimit vendor, në pajtim me këtë Statut dhe vendimet për themelim kujdesen për:

- **zgjedhjen e çështjeve të infrastrukturës komunale në territorin gjegjës;**
- **ndërtimin dhe mirëmbajtjen e objekteve me interes publik (ujësjellës, rrugë, shtëpi kulturore, objekte sportive etj);**
- **Mrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës;**
- **rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave të vendbanimeve fshatare;**
- **Ngritjen e iniciativave për rregullimin e hapsirës;**

- **Organizimin e manifestimeve kulturore, sportive, zbavitëse dhe të manifestimeve të tjera dhe**
- **punëve tjera me rëndësi të përditshme për jetën dhe punën e qytetarëve.**

Këshilli e formave të vetqeverisjes vendore jep propozim dhe iniciativa organeve kompetentë të komunës, për çështje nga fusha e arsimit, shëndetësisë mbrojtjes sociale dhe për çështjet e tjera me interes për qytetarët.

Neni 110

Punët nga neni 117 të këtij Statuti financohen nga:

- **mjetet që Komuna do t'i lejojë formave të vetqeverisjes vendore në pajtim me planprogramet e tyre të zhvillimit,**
- **mjetet që qytetarët dretëpërdrejtë i bashkojnë,**
- **mjetet që do të veçojnë persona të interesuar juridik dhe fizik,**
- **mjete nga kompensimi i shërbimeve dhe**
- **dhurata e mjete tjera.**

Neni 111

Organ i formës së vetqeverisjes vendore është Këshilli.

Këshillin e zgjedhin qytetarët e formës së vetadministrimit vendor në tubim të qytetarëve me votim të hapët, nëse tubimi nuk vendos që votimi të jet i fshehtë.

Këshilli përbëhet prej 3-7 anëtarëve.

Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat 4 vjet.

Neni 112

Vendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtar të Këshillit miraton Këshilli në përbërje të vjetër, më së voni 30 ditëve para përfundimit të mandatit.

Nëse vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk miratohet në afatin e paraparë, vendimin për shpalljen e zgjedhjeve të anëtarëve të Këshillit miraton Kryetari i komunës, në afat prej 15 ditëve.

Neni 113

Propozimi dhe verifikimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit bëhet ne Tubimin e qytetarëve

Neni 114

Të zgjedhur konsiderohen kandidatët që ka fituar shumicë gjegjësisht numrin më të madh të votave nga anëtarët të pranishëm në Tubim.

Neni 115

Procedura për propozim, verifikim dhe zgjedhje të anëtarëve të Këshillit më së përafërmi rregullohet me Rregullat e punës të formës së vetqeverisjes vendore.

Neni 116

Kandidatë të zgjedhur të Këshillit konsiderohen kandidatët që kanë fituar shumicë gjegjësisht numër më të madh të votave nga zgjedhësit që kanë votuar.

Neni 117

Këshilli nga anëtarët e vet zgjedh kryetarin i cili e prezenton dhe e përfaqëson formën e vetqeverisjes vendore.

Këshilli miraton rregulla me të cilat rregullohet puna e formës së vetqeverisjes vendore si dhe program për punë, pas mendimit paraprak të Këshillit të Komunës.

Neni 118

Kryetari i komunës, me aktvendim mundet të delegojë kryerjen e punës së caktuar me interes të drepëdrejtë dhe rëndësi të përditshme për jetën dhe punën e banorëve, kryetarit të Këshillit të formës së vetqeverisjes vendore.

Mjetet e nevojshme për ushtrimin e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen në aktvendimin për delegim të kompetencës.

Me aktvendimin përcaktohet organi dhe mënyra e kryerjes së mbikqyrjes së ekzekutimit të punëve nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 119

Administrata komunale kryen punët profesionale, administartivo - teknike dhe punët llogaritare-financiare të organit të formës së vetqeverisjes vendore.

Kontrollë mbi shpenzimin e mjeteve që do të transferohen për ushtrimin e kompetencave të deleguara kryen administrata komunale.

X. MËNYRA DHE PROCEDURA E PËRCAKTIMIT DHE PËRDORIMIT TË STEMËS DHE FLAMURIT TË KOMUNËS

Neni 120

Stema dhe flamuri i komunës përcaktohet me vendim të Këshillit të Komunës.

Për përcaktimin e stemës dhe flamurit të komunës, Këshilli i komunës shpall konkurs dhe formon komision.

Neni 121

Nga veprat e arritura në konkursin e shpallur, Komisioni përcakton propozimin për stemën gjegjësisht për flamurin e komunës dhe ia dërgon Këshillit të komunës për miratim.

Neni 122

Këshilli i Komunës me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të Këshillit vendos për propozimin e Komisionit.

Vendimi i Këshillit mbi përcaktimin e stemës gjegjësisht flamurit të komunës është pjesë përbërëse e Statutit të Komunës.

Neni 123

Stema e komunës përdoret në përbërje të vulës së komunës.

Stema e komunës mund të përdoret edhe në thirrje, kartolina urimi dhe akte të ngjajshme zyrtare që i shfrytëzojnë Këshilli dhe Kryetari i Komunës.

Këshilli i komunës mund të lejojë përdorimin e stemës së komunës nga ana e personave fizik dhe juridik nëse vlerëson se ajo është në interes të komunës.

Neni 124

Flamuri i komunës ngritet para ndërtesës të Këshillit të Komunës dhe vende të dukshme në komunë.

Flamuri i komunës mund të ngrihet edhe gjatë takimeve ndërkombëtare, garave dhe tubimeve të tjera në të cilat merr pjesë ose përfaqësohet komuna.

Neni 125

Stema dhe flamuri i komunës nuk duhet të përdoren nëse janë të dëmtuara ose me pamjen e tyre janë të papërshtatshme për përdorim

XI. MBROJTJA E KOMUNËS

Neni 126

Iniciativë për vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjeve dhe të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë së akteve të përgjithshme të Ministrive dhe organeve tjera të administratës shtetërore me të cilat prishet pozita kushtetuese dhe të drejtat e Komunës të përcaktuara me Kushtetutën dhe ligjet, mund të parashetrojnë

Këshilli gjegjësisht Kryetari i komunës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë.

Neni 127

Kryetari i komunës ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore para gjykatave kompetente kur Komunës i pengohet ushtrimi i kompetencave të dhëna me Kushtetutë dhe ligj, me akte dhe aktivitete të organeve të administratës shtetërore dhe të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

**XII. PËRDORIM I GJUHËVE DHE
SHKRIMEVE NË KOMUNËN E DIBRËS**

Neni 128

Në territorin e Komunës së Dibrës në përdorim zyrtar janë gjuha maqedone me alfabetin e saj cirilik dhe gjuha shqipe me alfabetin e saj.

Në seancat e Këshillit dhe trupat e saja në përdorim zyrtar është gjuha maqedone me alfabetin e saj cirilik dhe gjuha shqipe me alfabetin e saj.

Neni 129

Në shërbiet publike, institucionet publike, ndërmarrjet publike që i ka themeluar Komuna si dhe subjektet e tjera juridike në territorin e komunës së Dibrës, në përdorim zyrtar janë gjuha maqedone me alfabetin e saj cirilik dhe gjuha shqipe me alfabetin e saj.

Neni 130

Emrat e vendbanimeve në komunë, titujt e shërbimeve dhe institucioneve publike, mbishkrimet e institucioneve kulturore dhe arsimore, mbishkrimet e ndërmarrjeve dhe mbishkrimet e tjera publike dhe aktet e tyre të përgjithshme dhe të veçanta, si dhe korespondenca për komunikim me qytetarët dhe subjektët tjerë shkruhen në gjuhën maqedone me alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën shqipe me alfabetin e saj.

Mbishkrimet e institucioneve të kulturës dhe arsimit të cilat shërbejnë vetëm për zhvillimin dhe përparimin e qëllimeve kulturore dhe arsimore të nacionaliteteve, përveç në gjuhën maqedone dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuhën shqipe dhe alfabetin e saj, shkruhen edhe në gjuhën dhe shkrimin e bashkësive pavarësisht nga numri i përfaqësuesve të bashkësive që jetojnë në Komunën e Dibrës.

**XIII. PROCEDURA PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS**

Neni 131

Ndryshime dhe plotësime të Statutit të komunës mund të propozojnë së paku ½ e anëtarëve të Këshillit të komunës, Kryetari i komunës ose së paku 10% e zgjedhësve në komunë.

Neni 132

Vendim për inicim të ndryshimeve të Statutit miraton Këshilli i komunës me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit.

Ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të komunës miratohen nëse për ato ka votuar shumica e anëtarëve të Këshillit të Komunës.

XIV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 133

Dispozitat e neneve 15,16 dhe 17 të Statutit të Komunës së Dibrës (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr. 4/97) vashdojnë të zbatohen deri në sjelljen e ligjeve të veçanta.

Neni 134

Dispozitat e neneve 21,31,32,33,34,35,36,37,38,39,40,41,42 paragrafi 3, 111,112,113,114,115,116,117,118,119,120,121,122,123,124,125,126,127 të këtij Statuti do të hyjnë në fuqi në zgjedhjet e ardhëshme lokale.

Neni 135

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti pushon të vlejë Statuti i Komunës së Dibrës (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr. 4/97).

Neni 136

Ky Statuti hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në “Kumtesën zyrtare të komunës Dibër”.

**Nr. 07-168/3
03.10.2003
D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS
Kryesuesi,
Gëzim Haxhihalili d.v.**